

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Policia i gjeti kokainë brenda tavanit të banesës, dënohet me 32 muaj burg shqiptari në Skoci
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/policia-i-gjeti-kokaine-brenda-tavanit-te-baneses-denohet-me-32-muaj--i401297
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 21:02:40 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 20:56:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3e91e746b4b72996dfc63fbfd78607750a0f0ed7c04ea4e03298e94e92606c0e
TEKSTI	6c358811f46d1cbbd722d580488f066813d20552b71e879ba76a4fafa40dc3b2
PAMJA	e18eb772185af5f35f6859fa9903fc22f072ef2a965b18c5287344161fff544d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4c02e96ba7db7827e7a0d4cbc72b48e95bd9dcdd7def977b9a1ec0cb393acf5d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aa0d8cfc8113ea79b7663cf26341788a60de665698217179c4b01fa71930ced4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4c02e96ba7db7827e7a0d4cbc72b48e95bd9dcdd7def977b9a1ec0cb393acf5d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjikës

Aktualitet

15 Shtator 2026, 22:56

Policia i gjeti kokainë brenda tavanit të banesës, dënohet me 32 muaj burg shqiptari në Skoci



Shkruar nga Newsbomb



Foto Ilustruese

Një 31-vjeçar shqiptar është dënuar me 2 vite e 8 muaj burg në Skoci, pasi u kap si pjesë e një grupi që shpërndante kokainë.

Bëhet fjalë për Ervis Nezajn, i cili pranoi para Gjykatës së Sherifit në Aberdeen se ishte përfshirë në furnizimin me lëndë narkotike në periudhën nga maji deri në tetorin e vitit 2025. Sasia e drogës e kapur llogaritet me vlerë tregu deri në 109 mijë paund.

Gjithçka nisi në maj 2025, kur policia skoceze identifikoi një numër telefoni që përdorej për shitjen e drogës. Nëpërmjet përgjimeve dhe pamjeve të kamerave të sigurisë, hetuesit arritën tek Nezaj dhe tek një makinë Toyota me ngjyrë blu që ai përdorte.

Më 12 maj, efektivët ndaluan automjetin në rrugën Trinity Street në Aberdeen. Brenda tij gjetën 1,060 paund cash. Kontrolli u shtri më pas në disa banesa që dyshohej se shërbenin si baza të rrjetit. Në një shtëpi ku nuk banonte askush, u zbuluan dy qese me kokainë dhe pasaporta e shqiptarit. Ndërkohë në një apartament në Castle Street u gjetën 10 qese të tjera me kokainë dhe 280 paund.

Goditja finale u dha më 31 tetor. Nezaj u ndalua së bashku me një person tjetër në një makinë në Summerhill Terrace. Gjatë kontrollit policia i gjeti iPhone, 910 paund dhe disa çelësa. Brenda tavanit të makinës ishin fshehur tetë qese me kokainë. Një nga çelësat i përkiste pikërisht banesës në Eigie Walk, ku gjatë rikthimit atje u gjetën edhe tre qese të tjera, ndërsa brenda një altoparlanti ishin fshehur 848 gramë kokainë.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Bota

Detaje të reja nga vdekja e këngëtarit: Mjekja fshehu provat dhe dërgoi foton e Mazonakis te një i panjohur



Politikë

E mërkurë "e ethshme" në Kosovë, brenda dy orëve do të VULOSET drejtësi për ish-krautë e UÇK-së, Berisha del me mesazh: Ka vetëm një vendim, pafajësi!

Zbulu më shumë artikuj >

Në total u sekuestruan 874 gramë kokainë dhe 2,943 paund cash. Në seancën gjyqësore, avokati i tij tha se klienti ishte futur në këtë aktivitet për shkak të borxheve në Shqipëri dhe se pas vuajtjes së dënimit do të kthehej në vendin e tij. Gjykata u informua gjithashtu se Nezaj kishte një precedent penal në Angli për shpërndarje kanabisi.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Martë 21:51

Dita e 108-të e “Revolucionit Flamingo”, protestuesit e “shpërngulin” protestën te Mine Peza: Lironi qytetarët



Aktualitet

“Kryekuzhinieri i çorbës së derrit është vetë kryeministri”, Artan Hoxha “shpërthen”: Kur do Rama bëhet drejtësia, kur s’do nuk bëhet

🕒 E Martë 21:11



Aktualitet

Efektivët “ia qëlluan”, kokaina 2 milionë euroshe që u kap në Portin e Durrësit i përkiste vrasësit të “të fortit” të Tiranës, dy të tijët prapa hekurave (E PLOTË)

🕒 E Martë 21:06 Newsbomb



E Martë 20:03

Nga fusha në tregun european, Ministri i Bujqësisë: Toka mbetet e jotja, makineritë dhe tregu të përbashkëta



Aktualitet

E reja zbuloi SKANDALIN, Zegjineja thyen heshtjen për ngjarjen me dajën: I ati i Meritës ishte kundër! Dënoj çdo lloj dhune (REAGIMI)

E Martë 19:16



Aktualitet

I dënuar për dhunë, arrestohet 44-vjeçari shqiptar në Itali

E Martë 17:50



E Martë 17:31 Newsbomb

Apeli i dha lirinë në 2020, Gjykata e Lartë kthen për rigjykim dosjen e Ergys Kolaverit, donte të merrte gjakun e vëllezërve



Aktualitet

MIRATOHET drafti i PS për pagat e magjistratëve të "Ligjet", kalon në Kuvend këtë të enjte

E Martë 17:16



Aktualitet

Aksident i rëndë në Lezhë-Shkodër! Përplasen tre makina, raportohet për tre të plagosur (PAMJE NGA VENDNGJARJA)

E Martë 17:15





🕒 E Martë 17:11 Newsbomb

Aksident i rëndë në Maqellarë–Peshkopi, plagosen pesë persona, katër prej tyre nisen me urgjencë drejt Tiranës



Aktualitet

U arrestua dy muaj më parë, Gjykata e Tiranës vendos për ekstradimin e turkut të akuzuar për tentativë vrasje në Zvicër (EMRI)

🕒 E Martë 16:34



Aktualitet

Nisin punimet në Bypassin e Elbasanit, Karakaçi në terren: I jep zgjidhje trafikut të krijuar në autostradën Tiranë–Elbasan

🕒 E Martë 16:15



🕒 E Martë 15:40

Gjykata e Brazilit MIRATON ekstradimin e Ervin Matës, kushtet që Shqipëria duhet të plotësojë për të marrë “bolin e kokainës”



Aktualitet

Protestat në Shqipëri, ambasadori i Kroacisë mesazh qeverisë: Dëgjoni zërin e qytetarëve



Aktualitet

Ndahet nga jeta Dine Abazi, ish-presidenti i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë

🕒 E Martë 15:25

🕒 E Martë 15:05



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.